



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2975/2 prot.,

Datë 01.12.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK**  
**ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN DHE SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur*” me mjete elektronike” me nr. REF-77341-08-11-2023 me objekt: “*Shërbim për monitorimin e mjedisit*”, me fond limit 12,626,667 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 07.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a..

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Lënien të skualifikuar si edhe shtim të arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TENUIS LABORATORIES” SHPK

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK me NIPT K92402036A dhe adresë Zona Kadastrale 2679, hyrja 2, apartamenti 39, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Albpetrol sh.a. me adresë Lagjja “29 Marsi” Patos, Selia Rruga Fier – Patos, km 7.

**Subjekt i interesuar:** “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK me NIPT L51512009E dhe adresë Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Irfan Tomini, Pallati nr.50, Kati I – re.

“TENUIS LABORATORIES” SHPK me NIPT L81904506I dhe adresë Durres Durres Durres, KOXHAS, Rruga dytesore "Maminas-Vore", Nr 20/38, Koxhas.

Në datën 30.11.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3661 dhe protokolluar me nr. 2975/2023 prot., datë 30.11.2023 e operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK, Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues, pretendon se nga operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK nuk përmbushen kriteret për kualifikim si dhe për operatorin ekonomik “TENUIS LABORATORIES” SHPK pretendon që të mbetet i skualifikuar si edhe të shtohen arsye të skualifikimit për mospërmbushjen e kriterëve nga ky operator ekonomik, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

- *OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk ka deklaruar emrat e personit (personave) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, të cilët nuk janë ose nuk kanë qenë të dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së*

prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së ,(konkretisht emrat e Administratorit, Drejtuesit Teknik dhe Ortakut referuar QKB-së). Kjo në kundërshtim me kërkesat e gërmës “ç” të pikës “1” “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”, të shtojcës 8 të DST-së.

- OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk ka deklaruar në deklaratën “B” “Për dorëzimin e ofertave të pavaruara” nëse ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës “gj” të pikës “1” “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”, të shtojcës 8 të DST-së.

- OE nuk ka paraqitur kopje të certifikuar të bilancit për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të konfirmuar nga administrata tatimore. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.2.1. të pikës 2.2. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të DST-së.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimes, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, të kriterëve si më poshtë:

-Pretendon së oferta e operatorit ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, është anomalisht e ulët;

-2.3.9.Operatori ekonomik duhet të disponoje:

- Laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, të pakten 1(nje), për monitorimin e cilësive së ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave të referencës, i cili të jete në pronesi ose me qira.

Për këtë të paraqiten:

- Certifikata e akreditimit të laboratorit leshuar në emer të operatorit ekonomik.
- Nëse laborator është me qira ose me kontratë bashkëpunimi të paraqitet kontrata e qirase ose e bashkëpunimit e lidhur para noterit, me afat jo më të shkurter se periudha që do të ofrohet shërbimi së bashku me certifikatën e akreditimit.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

-Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

#### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Periudha e monitorimit do të jetë 12 mujore nga data e nënshkrimit të kontratës.

Referuar ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Neni 44 “Detyrimet e operatorit për monitorimin e përputhshmërisë” Pika 3 e këtij neni shprehet: “Operatori mund të kryejë monitorimin nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që ai disponon ose nëpërmjet laboratorëve të specializuar e të akredituar”, operatori ekonomikë duhet të ketë në pronësi ose me qira, laborator të akredituar për kryerjen e këtyre analizave, (për testimin e gazeve në ajër, zhurmave dhe ujrave të shkarkimit sipas elementëve të kërkuar në sëcilen prej Leje Mjedisore). Të disponojë Çertifikatë Akreditimi aktive për të gjithë periudhën e shërbimit të kërkuar dhe të ketë ekspertë të licensuar dhe me pervojë në fushën e monitorimeve mjedisore.

#### **2 - Monitorimi i cilësisë së ujrave në kanalizime dhe ujra sipërfaqësorë.**

Grimcat, PM10, Rrjedhja, pH, temperaturë, toksiciteti, TSS, NBO-5, NKO, COD, BOD5 Produkte naftë, Fenole volative, Sulfide, Klorure, Metale toksik (në total), Azot Amonjak N mg/l, Azot total, Fosfor total, Cd, Cr, Cr (VI), As, Pb, Hg, Zn, Fe, Ni, Cianid i lirë, Cianid Total.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon pretendimet e operatorit ekonomik “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK që të mbetet i skualifikuar operatori ekonomik “TENUIS LABORATORIES” SHPK, si edhe të shtohen arsye të skualifikimit për mospërbushjen e kritereve nga ky operator ekonomik si më poshtë vijon:

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërbushjen e kritereve si më poshtë vijon:

-2.3.9.Operatori ekonomik duhet te disponoje:

- Laborator te akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, te pakten 1(nje), per monitorimin e cilesise se ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave te references, i cili te jete ne pronesi ose me qira.

Për këtë të paraqiten:

- Certifikata e akreditimit te laboratorit leshuar ne emer te operatorit ekonomik.
- Nese laboratori eshte me qira ose me kontrate bashkepunimi te paraqitet kontrata e qirase ose e bashkepunimit e lidhur para noterit, me afat jo më te shkurter se periudha qe do te ofrohet sherbimi se bashku me certifikaten e akreditimit.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatoret ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

-Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

## FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Periudha e monitorimit do të jetë 12 mujore nga data e nënshkrimit të kontratës.

Referuar ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Neni 44 “Detyrimet e operatorit për monitorimin e përputhshmërisë” Pika 3 e këtij neni shprehet: “Operatori mund të kryejë monitorimin nëpërmjet pajisjeve dhe instrumenteve të akredituara që ai disponon ose nëpërmjet laboratorëve të specializuar e të akredituar”, operatori ekonomikë duhet të ketë në pronësi ose me qera, laborator të akredituar për kryerjen e këtyre analizave, (për testimin e gazeve në ajër, zhurmave dhe ujrave të shkarkimit sipas elementëve të kërkuar në sëcilën prej Leje Mjedisore). Të disponojë Çertifikatë Akreditimi aktive për të gjithë periudhën e shërbimit të kërkuar dhe të këtë ekspertë të licensuar dhe me pervojë në fushën e monitorimeve mjedisore.

### **1 - Monitorimi i cilësisë së ajrit**

Grimcat, PM10,

Gazet në mjedis SO<sub>2</sub>, O<sub>2</sub>, NO<sub>x</sub>, TOC, H<sub>2</sub>S, CO.

### **2 - Monitorimi i cilësisë së ujrave në kanalizime dhe ujra sipërfaqësorë.**

Grimcat, PM10, Rrjedhja, pH, temperaturë, toksiciteti, TSS, NBO-5, NKO, COD, BOD5  
Produkte naftë, Fenole volative, Sulfide, Klorure, Metale toksik (në total), Azot Amonjak N mg/l, Azot total, Fosfor total, Cd, Cr, Cr (VI), As, Pb, Hg, Zn, Fe, Ni, Cianid i lirë, Cianid Total.

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues “Qendra e Monitorimit të Mjedisit” SHPK kërkon anulimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar, pasi kriteri kualifikues i përcaktuar në pikën 2.2.1. të shtojcës 8 të DST-ve (kriter për të cilën oferta jonë është skualifikuar), është hartuar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 43/4 të VKM nr.285 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 01.12.2023.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**